



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:133239

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05665106

C.nr.25/19

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Shemsedin Haxhijaj, në çështjen juridike të paditësit F.J.S nga fshati S.... K.Istog, të cilin e përfaqëson R.SH avokat nga Istogu, kundër të paditurit F.Z nga Istogu Rr. “.....” NR., nga baza juridike: anulim kontrate/ kthim borxhi, me vlerë kontesti 500.00 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur, me datë 19.03.2024, e në prani të autorizuarit të paditësit, si dhe të paditurit, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.J.S nga fshati S.... K.Istog, ashtu që **DETYROHET** i padituri F.Z nga Istogu Rr. “.....” NR., që paditësit F.J.S nga fshati S.... K.Istog, t’ia paguajë shumën në lartësi prej 11,000.00 euro në emër të pasurimit të pabazë, e këto me kamatë ligjore prej 8%, nga data 24.01.2019 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. REFUZHET** kërkesëpadia e paditësit F.J.S nga fshati S.... K.Istog me të cilën kanë kërkuar që të ANULOHET Kontrata private mbi shitblerjen e patundshmërisë së datës 18.01.2008 e nënshkruar në mes të F.Z dhe F.J.S si NUL.
- III. DETYROHET** i padituri F.Z nga Istogu Rr. “.....” NR., që paditësit F.J.S nga fshati S.... K.Istog të ia paguajë shpenzimet procedurale në shumën në lartësi prej 664 euro, në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 24.01.2019, ku me padi si dhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të DETYROHET i padituri F.Z nga Istogu Rr. “.....” NR., t’ia paguaj në emër të borxhit shumën prej 11.000 euro me kamatë ligjore të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, dhe të ANULOHET Kontrata private mbi shitblerjen e patundshmërisë së datës 18.01.2008 e nënshkruar në mes të F.Z dhe F.J.S si NUL

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se përmes provave të administruara nga ana e kësaj gjykate konsiderojmë se u vërtetua se kontrata qe ka të bëjë me shitblerjen e banesës e përpiluar me dt. 18.01.2008 tek avokati Z.B është absolutisht nule pasi që e njëjta përveç mangësive të përshkruara në padi është fakt se nuk është përpiluar dhe vërtetuar në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi pasi qe kemi të bëjmë me shitblerje te patundshmërisë e që për këtë lloj transaksioni me dispozita ligjore është paraparë forma dhe vërtetimi pranë organit kompetent. Prandaj, për këtë fakt kontratën e lartcekur e konsiderojmë të pa vlefshëm dhe nule dhe rrjedhimisht nga nuliteti i saj rrjedh kthim i obligimit dhe atë në shumën prej 11.000 euro, pasi që kjo shumë po thuajse nuk është kontestuese nga ana e palës se paditur, kështu qe i propozohet gjykatës aprovimi i kërkesëpadsisë, shpenzimet procedurale i kërkojmë, për përpilim të padsisë 104 euro, 20 euro për taksë gjyqësore, për përfaqësim në 4 seanca, me dt. 09.11.2023, 27.12.2023, 08.02.2024 dhe sot 19.03.2024 nga 135 euro.

I padituri me përgjigje në padi si dhe gjatë shqyrtimit kryesor e në fjalën përfundimtare ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se njëjta është në tërësi si e pa bazuar, pasi qe nuk ka mbështetje ligjore dhe faktike sepse nuk ka mbështetje në shkresa të lëndës dhe një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që për banesën në fjalë unë fillimisht kam pasur autorizim gjeneral nga pronarja ZH.B dhe e njëjta ka qenë e uzurpuar nga SH.G ku në bazë ligjore dhe me përkrahjen e policisë dhe Habitatit të njëjtën e kam larguar nga banesa të cilën pastaj e kam rinovuar dhe të njëjtën ja kam shitur F.S në shumën prej 25.000 euro, mirëpo i njëjti mi ka paguar vetëm 10.000 euro ndërsa pjesa tjetër e mbetur nuk është paguar asnjëherë nga ana e blerësit, duke shtuar se mbesë në tërësi pranë deklarimeve të dhëna nga seancat e kaluara si dhe në seancën e sotme, duke shtuar se deklarimi i të autorizuarit të paditësit se kinse kontrata është absolutisht e pa vlefshme, nëse atëherë është e pa vlefshme cila është arsyeja pse jam në këtë procedurë, nëse ajo kontratë është 0 atëherë edhe borxhi është 0, dhe nuk ndiej obligim ndaj paditësit sepse e kam familjar dhe asnjëherë nuk i ka kërkuar deri me tani, ma ka ditë shtëpinë, ndoshta i kisha dhënë diçka, as familjaret të cilët kanë ndërmjetësuar nuk kanë kërkuar asgjë dhe mbi bazën e këtyre i propozojmë gjykatës qe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik të datës 19.03.2024 sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: kontratën private mbi shitblerjen e banesës e lidhur me dt. 18.01.2008 në zyrën e avokatit Z.B në Istog, në mes të shitësit F.Z dhe blerësit F.S këtu paditësit, kontratës për shitblerjen e patundshmërisë në pronësi etazhe LRP.nr.3316/2016 Ref.nr.406/2016 e dt. 08.08.2016 e vërtetuar te noteri A.G në Istog në mes shitëses ZH.B dhe blerëses E.S, urdhërpagesa e realizuar përmes Pro Credit Bank nga blerësja tek shitësja e banesës e datës 08.08.2016, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor është bërë procedimi i palëve paditësit F.S dhe të paditurit F.Z, si dhe në cilësi të dëshmitarit procedoi Z.B nga Istogu rr.“/...” NR..

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, çmuarjes me kujdes e ndërgjegje të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti

në përfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që me provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga kontrata për shitblerjen e patundshmërisë në pronësi etazhe banesë LRP.nr.3316/2017 Ref.nr.406/2016 e dt. 08.08.2016 e vërtetuar tek noteri A.G në Istog e bërë në mes shitëses ZH.B dhe blerëses E.S vërtetohet kalimi i patundshmërisë nga shitësja ZH.B tek blerësja E.S.

Nga urdhërpagesa e realizuar përmes bankës Pro Credit Bank nga blerësja E.S tek shitësja ZH.B e banesës e datës 08.08.2016 vërtetohet se është realizuar në emër të shitblerjes së patundshmërisë në shumën prej 25.000.00 euro për banesën nr. njësie 0-.-.-0-.-.-0, 72m2, e cila ndodhet në Z.K. Istog.

Nga kontrata private mbi shitblerjen e patundshmërisë të lidhur në mes shitësit F.Z dhe blerësit F.S me datë 18.01.2008 vërtetohet fakti se e njëjta është lidhur pranë Zyrës së Avokatit Z.B në Istog.

Paditësi ka kërkuar borxhin nga i padituri, por realisht në mesë palëve nuk ka pas huadhënie për të kërkuar borxhin. Sipas dispozitës së nenit 253, par. 2 të LPK-së, gjykata nuk është e lidhur për bazën juridike, të cilën e ka paraqitur pala paditëse në padinë e tij, prandaj gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore, nga gjendja faktike e vërtetuar del së kem të bëjmë me pasurim të pa bazë dhe jo borxh, si dhe duke iu referuar nenit 2.2 të LPK-së, ku parasheh së gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale.

Ngase në mes ndërgjyqësve nuk ka qenë kontestues kontakti në mes tyre dhe lidhja farefisnore, po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësi dhe i padituri kishin lidhur kontratë private të shitblerjes për patundshmërinë përkatësisht banesën, kontestuese nuk ka qenë as shuma e të hollave të cilat paditësi ja ka dhënë të paditurit në emër të shitblerjes se banesës.

Kontestuese këtu ka qenë çështja se a ka pasur i padituri autorizim që ta shes patundshmërinë përkatësisht banesën e cila ka qenë në pronësi të ZH.B, dhe kthimi i mjeteve në emër të shitblerjes.

Pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar vetëm sa i përket pjesës aprovuese në emër të pasurimit të pa bazë .

Gjykata me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes faktike ka proceduar në cilësi të palës-paditësin F.S nga fsh. S... me vendbanim në Gjermani, i cili ka deklaruar se lidhur me çështjen e marrëveshjes me të paditurin rreth kësaj banese, ka kaluar një kohë e gjatë prej 2006 mund që në detaje të mos më kujtohen, unë kam kontaktuar me të paditurin përmes një mikut tim i cili më ka thënë se ka raport të mirë me të si shok shkolle, ushtrie etj., dhe pazarin e ka bërë vëllai i gruas me F.1 duke e pyetur sa po e lë banesën, ai i ka thënë se çmimi është 20.000 euro, miku është kthyer për në Zvicër më ka lënë numrin kontaktues të paditurit, e kam thirrur dhe ka ardhur para

banesës dhe më ka thënë se çmimi është 22.000 euro edhe për kundër dallimit të shumave të cilat i ka dhënë mikut dhe mua, jemi dakorduar që çmimi të jetë 20.000 euro dhe kemi shkuar s'bashkua tek avokati Z.B ku kemi formuluar kontratën dhe pagesa ka qenë e rregulluar që fillimisht ti jap 13.000 euro dhe 2.000 euro mi ka kthyer për renovim të banesës, ndërsa 11.000 euro janë dhënë në dorë në prezencë të avokatit Z.B dhe pjesa tjetër ka mbetur që si të bartet pronësia qoftë tek unë apo tek bashkëshortja të paguhet pjesa tjetër prej 9.000euro. Pas kësaj unë kam filluar ta rinovojë banesën dhe ky ka ra në burg dhe bashkëshortja ka qenë vetë dhe pastaj janë paraqitur Habitati në vitin 2016 pronarja më ka thënë që ja lësho banesën ja blejë, atëherë unë kam pasur kontakt direkt me pronaren dhe e kam blerë banesën dhe unë i kam thënë F.1 eja sepse pronarja është duke ardhur dhe mos më thuaj më vonë më ke hyrë në mes, i njëjti më ka thënë se vetëm kryej punë sepse unë parat do ti kthejë, përfundimisht 11.000 euro i padituri duhet të mi kthejë i cili ka pranuar vazhdimisht që të mi kthej por asnjëherë deri më tani nuk mi ka dhënë.

Në cilësi të palës gjykata ka proceduar edhe të paditurin F.Z nga Istogu Rr. “.....” NR. i cili ka deklaruar: kontratën e shitblerjes e kam lidhur me paditësin ku unë kam pasur cilësinë e të autorizuarit nga pronarja që ta shes banesën, janë zhvilluar negociatat rreth shitblerjes, çmimi ka qenë 25.000 euro, vjehrra e paditësit ka kërkuar dhe iniciuar që çmimi të jetë 20.000 euro, po atë ditë kemi shkuar tek avokati Z.B e kemi bërë një kontratë të shit-blerjes dhe shumen prej 13.000 euro mi ka qit në xhirollogari bashkëshortja e tij për shkak të lidhjes familjare që paditësin e kam tezak, prej kësaj shume paditësi ka kërkuar huazim shumë prej 3.000 euro ose 2.000, gati 1 vit e ma shumë nuk e ka pruar shumë tjetër, prej 9.000 euro, 7.000 euro kanë qenë të shitblerjes dhe 2.000 euro kanë qenë hua që ja kam huazuar, dhe në ndërkohe unë kam qenë në vuajtje të dënimit dhe më nuk është përmbushur shuma tjetër. Pasi kam dal nga burgu edhe unë edhe ata kemi insistuar që të përmbushet pjesa tjetër por këta kanë thënë se kemi punë me Habitatin dhe pronaren, pas një kohe me ka thënë se a ka mundësi që unë ta blejë prej pronares direkt, ndërsa pjesën të cilën ta kam dhënë po ta fali, për hire të asaj që e ke liruar banesën dhe se ja kam dhënë lidhjen me ish pronaren, por dhe prej asaj kohe me nuk e ka kërkuar dhe nuk kemi pasur kurrfarë problemi, dhe nga gjithë kjo konsideroi se nuk kam obligim ndaj paditësit se ka qenë marrëveshja si më lartë, nëse ai është pishman unë mund të ja kthej shumë dhe me kusht që ai të më lëshoi banesën.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes faktike në seancën e datës 19.03.2024 ka proceduar në cilësi të dëshmitarit Z.B nga Istogu rr. “/...” NR. i njëjti ka deklaruar: Po, kanë përpiluar një kontratë private me dt. 18.01.2008 pas verifikimit të palëve kontraktuese F.Z dhe F.S në bazë të letërnjoftimit që kanë prezantuar, kanë deklaruar bashkërisht se janë marr vesh për shitjen - blerjen e një banese siç kanë deklaruar ata në rr. “...” banesë pjese edhe një garazhde, në çmim në shumë prej 20.000 euro, sipas marrëveshjes së tyre në piken 2 të kësaj kontratë blerësi ka pasur obligim të ja bart shumë prej 13.000 euro me datë të nënshkrimit të kësaj kontratë dt.18.01.2008, ndërsa shuma e mbetur prej 7.000 euro të ja paguaj në shtator të vitit 2008 pasi që shitësi të i siguroi dokumentet përkatëse, për bartjen e pronës të banesës se shitur në emër të blerësit. Në zyrën time përveç përpilimit të kontratës dhe vendosjes se nënshkrimit nuk ka pasur këmbim të hollave.

Faktin se paditësi e ka paguar shumën fillimisht 13,000.00 euro, të paditurit në emër të shitblerjes së patundshmërisë e më pastaj nga e njëjta shumë i padituri ja kishte dhënë 2.000 euro, për renovimin e banesës këtu paditësit, gjykata e vërtetoi nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse të bëra në cilësi të palëve ku edhe paditësi ka deklaruar se “jemi dakorduar që çmimi të jetë 20.000 euro dhe kemi shkuar s’bashkua të avokati Z.B, ku kemi lidhur kontratën dhe pagesa ka qenë e rregulluar që fillimisht ti jap 13.000 euro dhe 2.000 euro mi ka kthyer për renovim të banesës, ndërsa 11.000 euro janë dhënë në dorë në prezencë të avokatit Z.B dhe pjesa tjetër ka mbetur që si të bartet pronësia qoftë tek unë apo tek bashkëshortja të paguhet pjesa tjetër prej 9.000euro”, ku këtë e konfirmon edhe vetë i padituri i cili në cilësi të palës ka deklaruar “kontratën e shitblerjes e kam lidhur me paditësin ku unë kam pasur cilësinë e të autorizuarit nga pronarja që ta shes banesën, janë zhvilluar negociatat rreth shitblerjes, çmimi ka qenë 25.000 euro, vjehrra e paditësit ka kërkuar dhe iniciuar qe çmimi të jetë 20.000 euro, po atë ditë kemi shkuar tek avokati Z.B e kemi bërë një kontratë të shit-blerjes dhe shumen prej 13.000 euro mi ka qit në xhirollogari bashkëshortja e tij për shkak te lidhjes familjare qe paditësin e kam tezak, prej kësaj shume paditësi ka kërkuar huazim shumë prej 2.000 euro, gati 1 vit e ma shumë nuk e ka sjell shumën tjetër, prej 9.000 euro, 7.000 euro kanë qenë te shitblerjes dhe 2.000 euro, kanë qenë hua qe ja kam huazuar, dhe në ndërkohe unë kam qenë në vuajtje te dënimit dhe më nuk është përmbushur shuma tjetër”, po ashtu kjo konfirmohet edhe nga deklaratimet e dëshmitarit Z.B ku i njëjti ka deklaruar “kanë përpiluar një kontrate private me dt. 18.01.2008 pas verifikimit te palëve kontraktuese F.Z dhe F.S në bazë te letërnjoftimit që kanë prezantuar, kanë deklaruar bashkërisht se janë marr vesh për shitjen - blerjen e një banese siç kanë deklaruar ata në rr. “.....” banesë pjese edhe një garazhde, në çmim në shumën prej 20.000 euro, sipas marrëveshjes së tyre në pikën 2 te kësaj kontrate blerësi ka pasur obligim të ja bart shumën prej 13.000 euro me datë të nënshkrimit te kësaj kontrate dt.18.01.2008, ndërsa shuma e mbetur prej 7.000 euro të ja paguaj në shtator të vitit 2008 pasi që shitësi të i siguroi dokumentet përkatëse, për bartjen e pronës te banesës se shitur në emër te blerësit.

Faktin se i padituri nuk ka pasur autorizim që të bëjë shitblerjen e patundshmërisë kontestuese ,gjykata e konsideroj si të provuar përmes dëgjimit të dëshmitarit i cili ka konfirmuar së padituri nuk ka pasur autorizim kur ka lidhe kontratën joformele, po ashtu edhe i padituri në asnjë rrethanë nuk ka argumentuar me prova se ka pasur autorizim për të kryer shitblerjen e patundshmërisë, ku në bazë të nenit 7.1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se “Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)”. Ndërsa me nenin 319 të LPK-së parashihet: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Me nenin 210 par.1 të Ligjit të vjetër mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së, ish-RSFJ-së), bëhet fjalë për pasurimin e pa bazë, ndërsa me nenin 214 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: ”Kur kthehet ajo që është fituar pa bazë, duhet të kthehen frutet dhe të paguhet kamatëvonesa, e

pikërisht, në qoftë se fituesi është i pandërgjegjshëm, që nga dita e fitimit, e për ndryshe që nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Sipas dispozitës së nenit 210 par 2 të LMD-si kusht themelor për pasurim të pabazë është që pasurimi të jetë pa bazë juridike.

Nga dispozitat e lartcekura më lartë duhet të plotësohen kushtet ligjore për kompensim në emër të pasurimit të pabazë e në rastin konkret janë plotësuar elementet të cilat e karakterizojnë pasurimin pabazë edhe ato : Rritja e pasurisë në një anë, - Zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, - Lidhja shkakësore ndërmjet kësaj rritjeje dhe zvogëlimit të pasurisë, - Mosekzistimi i bazës në ndonjë punë juridike, vendimi të gjykatës ose të ndonjë organi tjetër shtetëror apo ligji.

Paditësi me anë të padisë ka kërkuar që i padituri të i kthejë shumën të cilën e ka fituar pabazë, duke e varfëruar të njëjtin dhe duke i shkaktuar dëm të njëjtit, ndërsa në bazë të provave materiale në lëndë, gjykata vërtetohet se i padituri me qëllim të përfitimit të pabazë, në dëm të paditësit ka përfituar shumën prej 11,000.00 euro. Në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar fakti se i padituri në cilësinë e të autorizuarit të palës shitëse , pa autorizimin lidhe kontrate jo formale me paditësin për shitblerjen e banesës duke pranuar edhe shumën e të hollave prej 11,000.00 euro, i cili fakt është provuar përmes dëgjimit të paditësit, dëshmitarit Z.B dhe vete pohimit të paditurit së ka pranuar këtë shumë por nuk ka obligim që të kthen pasi që i njëjti nuk e ka përmbushur pjesën tjetër.

Më Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (ish-RSFJ-së, vitit 1978), nga nenet 26, 28, 31, 46 paragrafi 1 dhe 2, 47, 51 paragrafi 1, 2 dhe 3, 52, 53, 60, 61, 67, 70, 103, 110, 111, 112, 117, 139, 142, dhe 148, rezulton se për të kërkuar anulimin e kontratave duhet të plotësohen disa kushte dhe atë: të cenohet interesi i përgjithshëm apo interesi individual dhe varësisht a cenohet interesi i përgjithshëm apo interesi individual kemi të bëj me pavlefshmëri absolute apo pavlefshmëri relative të kontratave. Pavlefshmëri absolute të kontratave kemi në të gjitha ato raste kur kontratat janë lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, janë lidhur në kundërshtim me normat e moralit dhe janë lidhur në kundërshtim me normat e dokeve të mira afariste siç përcaktohet në nenin 103 të LMD-së, ndërsa me pavlefshmëri relative të kontratave kemi të bëjmë në të gjitha ato raste kur kontratat janë lidhur nga personi i mitur me aftësi të kufizuar punuese, pa lejen e prindërit apo kujdestarit, kur kontrata lidhet me kërcenim, kur kontrata lidhet me lajthim esencial, kur kontrata lidhet me mashtrim dhe kur kontrata lidhet në mënyrë fiktive, siç përcaktohet me nenin 56, 60, 61, 65 dhe 66 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kërkesës që të ANULOHET Kontrata private mbi shitblerjen e patundshmërisë së datës 18.01.2008 e nënshkruar në mes të F.Z dhe F.J.S, dhe të shpallët si nule, pasi që kjo kontratë nuk është juridikisht e vlefshme. Kontrata për shitblerjen e paluajtshme duhet të bëhet me akt të vërtetuar tek organi kompetent, vetëm në këtë mënyrë vullneti i palëve në një veprim juridik siç është ai i tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme është i ligjshëm dhe i plotë. Nën këto rrethana e njëjta nuk mund ti nënshtrohet rregullave të anulimit të kontratës.

Meqenëse i padituri ka rënë në vonesë, gjykata në bazë të nenit 382 par.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroj të paditurin që paditësit në shumën e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi t'ia paguaj edhe me kamatën ligjore 8%, duke iu llogaritur nga data 24.01.2019 e deri në paguarjen definitive.

Me dispozitën e nenit: 452.3 të LPK – së, shprehimisht është përcaktuar se ‘Gjykata mund të vendos që njëra palë t’i shpërblej të gjitha shpenzimet që kanë pasur pala kundërshtare dhe ndërhyrësi që i është bashkuar, në qoftë se pala kundërshtare nuk ka pasur sukses vetëm në pjesën proporcionalisht të pa rëndësishme të kërkesës së vet, kurse për shkak të kësaj pjese nuk janë krijuar shpenzime të veçanta’.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara si në piken III të dispozitivit të këtij aktgjykimi për të cilat shpenzime detyrohet i padituri që ti kompensoj paditësit, i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të palës paditëse dhe atë: për 4 seanca gjyqësore të datave 09.11.2023, 27.12.2023, 08.02.2024 dhe 19.03.2024 secilën nga 135 euro, në shumën prej 540 euro, për përpilimin e padisë në shumën në lartësi prej 104 euro, sipas Tarifës së OAK- së, si dhe taksës gjyqësore në vlerë prej 20 euro, e në total shumën prej 664 euro.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin: 143 të LPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NE ISTOG, Departamenti i  
Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.25/19 datë 19.03.2024**

**Gj y q t a r i**  
Shemsedin Haxhiaj

**Udhëzim juridik :**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës se Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.